

# AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

## “Promo Dental” sh.p.k

Në bazë të ligjit ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për shoqëritë tregtare”, me vullnetin e tyre të lirë të shprehur në nënshkrimin e këtij Akti, sot më datë 07.05.2024 Themeluesit:

1. **Elis Topalli**, lindur në Mamurra, Shqiperi me 23.06.1990 , me nr. personal J00623074Q ,
2. **Iridi Vokshi**, lindur në Durrës me 10.07.1990, me nr. personal J00710094O,

Deklarojne se kane vendosur të nënshkruajne këtë kontratë themelimi për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë refereruar si Shoqëria), aktiviteti i së cilës rregullohet nga Akti i Themelimit dhe Statuti duke respektuar edhe kërkesat e legjislacionit shqiptar për shoqëritë tregtare.

### **Neni 1-Emërtimi**

Emërtimi i shoqërisë është

## “Promo Dental” sh.p.k

### **Emri tregtar i shoqërisë : “Promo Dental” SHPK**

Ne të gjitha aktet e dokumentat që dalin nga shoqëria emertimi i saj do të paraprihet (ose do të ndiqet menjëherë) nga inicialet “SH.P.K” dhe nga shpallja e kapitalit themeltar.

### **Neni 2-Vëndndodhja e selisë**

**Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet:** Lagjia nr. 5, Rruga Mujo

Ulqinaku, Objekt me nr. pasurie 7/291, Zona Kadastrale 8513, Kati i

dyte;



### **Neni 3- Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë pa afat, duke filluar prej datës së rregjistrimit të saj në Qendren Kombetare të Rregjistrimit.

### **Neni 4- Objekti i veprimtarisë**

- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si vijon:

#### **Në fushën e tregtisë shoqëria do të kryejë:**

-Organizimi dhe promovimi i turizmit dentar, duke përfshirë ndërmjetësimin midis klientëve tanë dhe klinikave të licensuara dentare e stomatologjike, si dhe konceptimi dhe programimin e gjithë kohës së qëndrimit në Shqipëri (bileta avioni, rezervime hoteli, programim vizitash kulturore në objekte të ndryshme turistike), transferi Aeroport-Hotel- Aeroport dhe Hotel-Klinikë- Hotel, asistencë turistike gjatë gjithë kohës së qëndrimit në Shqipëri.

-Promovimi dentar nepermjet marketingut digjital , marketingut telefonik , duke menaxhuar platformat Google, Rrjete Sociale etj per gjenerimin e leadsave

-Shoqëria bashkëpunon me agjensi të tjera turistike, udhëtimi, klinika dentare e stomatologjike, shoqëri transporti, etj, vendase dhe / apo të huaja, hotele, resorte, restorante, individë, familje, etj, që kanë objekt veprimtarie të njëjtë me të apo që lidhen me objektin e saj të veprimtarisë. -- Veprimtari të tjera në fushën e turizmit dentar , pjesëmarrje në panairë, hapje agjensi udhëtimi dhe marketing, veprimtari në fushën e hotelerisë, bar kafe, restorante, etj.


-Shoqëria mund të kryejë cdo operacion tregtar, si edhe të blejë dhe të shesë ose të marrë me qera ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë interesa ose pjesëmarrje në shoqëri, ente, të themeluara apo në themelime sipër, që kanë objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin, apo gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

### **Neni 5- Kapitali Themeltar**

**Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (Njëqind mijë ) leke.**

Kapitali perbehet nga 2 (dy) kuota me vlerë 50.000 (Pesedhjetë mijë) leke dhe 50.000 (Pesedhjetë mijë ) lekë, të shlyera në masë 100% nga Ortakët themelues. Ai mund të zmadhohet dhe të zvogëlohet me vendim të Ortakëve sipas normave të fushës në fuqi.

### **Neni 6-Kontributet dhe pjesët e kapitalit themeltar**



**Kapitali themeltar i shoqërise është 100.000 (Njëqind mije) leke** i cili perbehet nga 2 (dy) kuota perkatesisht:

1. **Elis Topalli**, lindur në Mamurra, Shqiperi me 23.06.1990 , me nr. personal J00623074Q , vlere e kapitalit te pergjithshem **50.000** Leke, numri i pjeseve 1, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. **Iridi Vokshi**, lindur në Durrës me 10.07.1990, me nr. personal J00710094O, vlere e kapitalit te pergjithshem **50.000** Leke, numri i pjeseve 1, qe perben 50% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjeset e kapitalit themeltar nuk mund te perfaqesohen nga letra me vlere te tregtueshme dhe as me kontribute ne sherbime.

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise

### **Neni 7- Transferimi i pjesëve të kapitalit**

1. Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i shoqërisë.

### **Neni 8- Administrimi**


1. Shoqëria administrohet nga një ose disa administrator, qofshin këta edhe jo ortak, të cilët emërohen ose shkarkohen nga Asambleja e Zakonshme.
2. Administratori është përfaqësuesi ligjor i shoqërisë. Ai ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët, në interes të shoqërisë, dhe në emër të saj në të gjitha rrethanat që kanë lidhje me objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti ja jep Asamblesë së Ortakëve.
3. Eshte vendosur administrim i perbashket nga palet :

**Ermira Koci**, lindur në Corovode me 22.02.1994, me nr. personal J45222057A , , me **afat 5- vjecar deri me 07.05.2029 me te drejt rizgjedhje.**

Të gjitha shpenzimet, taksat dhe honoraret e paguara për këtë akt dhe aktet që rrjedhin prej tij u perkasin bashkarisht dhe solidarisht nënshkruesëve në përpjestim me kontributet e tyre deri sa shoqëria të rregjistrohet në rregjistrin tregtar.

### **Neni 9- Të tjera**

1. Shoqëria do ta ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi.



### **Neni - 10**

1. Të gjitha kundërshtimet ose mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj midis ortakëve ose një ose më shumë ortakëve dhe Shoqërisë do të diskutohen në menyre të drjetpëdrejtë midis të interesuarëve për ti zgjidhur me pajtim. Në rast të kundërt i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.

### **Neni - 11**

1. Ky Akt Themelimi është përgatitur në katër kopje të barabarta dhe të barazvlefshme.

*Parë dhe miratuar në Durrës , më 07.05.2024*

## **ORTAKET E SHOQERISE**

**Iridi VOKSHI**

IRIDI VOKSHI



**Elis Topalli**

Elis Topalli

